

VENDIM
Nr. 884, datë 27.12.2022

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2023, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2023, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 56 403 200 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e tre mijë e dyqind) lekë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

Aneksi nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2023

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2023 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	34 619 660
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	6 052 270
3.	Shërbime e furniturë	15 231 270
4.	Investime	500 000
	TOTALI	56 403 200